

Aktiviteti kreditues dhe depozitues për bankat e nivelit të dytë gjatë periudhës janar- qershor 2004

Nga përpunimi i opinioneve të të intervistuarve dhe nga ecuria e indekseve të ndërtuara për treguesit e aktivitetit kreditues dhe depozitues rezultoi se:

Aktiviteti kreditues:

- niveli mesatar i realizimit të planit për kredinë është rreth 87 për qind, duke pësuar një rënie të lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003;
- madhësia e tregut joformal është reduktuar krahasuar me gjashtë muaj më parë;
- rreziku i procesit të kredidhënies konsiderohet të mos ketë ndryshuar, pavarësisht se vihet re një besim për rënien e lehtë tij. Për gjashtëmujorin e ardhshëm pritet të qëndrojë në të njëjtat nivele;
- kriza energjitike mendohet se nuk ka ndikuar në shlyerjen dhe kërkesën për kredi, si dhe pritet që edhe në të ardhmen të mos ndikojë procesin e kredidhënies;
- preferenca për kreditim sipas llojit të biznesit ka mbetur e pandryshuar; biznesi i mesëm është më i preferuari;
- sipas opinioneve të të intervistuarve, për të ardhmen pritet:
 - rritje e aktivitetit kreditues dhe në veçanti të kredisë për bizneset;
 - rritja e kreditimit në valutë do të jetë më e theksuar se sa e kreditimit në lekë;
 - normat e interesit të kreditimit në lekë pritet të ulen; ndërsa për kreditimin në valutë, nga pjesa më e madhe pritet të mbetet e

pandryshuar ndërsa ka pësuar rënie specialistët që besojnë për një renie të këtyre normave.

- Rënditja e preferencave për sektorët e ekonomisë nuk ka ndryshuar. Sektori i tregtisë do të vazhdojë të jetë sektori më i preferuar për kreditim.

Aktiviteti depozitues

Nga përpunimi dhe analiza e pyetësorëve të aktivitetit depozitues rezulton se:

- aktiviteti depozitues në tërësi gjatë periudhës janar – qershor 2004 është cilësuar si më i mirë krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës;
- më së shumti, bankat kanë realizuar objektivat mbi 100 për qind për depozitat në lekë por kanë mbetur në realizimet në masën 50-100 për qind për depozitat në valutë. Kjo vlen si për sistemin bankar në përgjithësi ashtu dhe për Bankën e Kursimeve në veçanti;
- diferenca e normave të interesit midis depozitave në lekë dhe në valutë ka vazhduar të favorizojë rritjen e depozitave në lekë ndërsa ka frenuar ritmet e rritjes së depozitave në valutë në këtë periudhë;
- indeksi i besimit i ecurisë së depozitave në lekë dhe në valutë ka një kthesë rritëse që nënkupton se ecuria e aktivitetit depozitues në gjashtëmujorin e ardhshëm shihet me optimizëm. Specialistët presin rritje të nivelit të depozitave në lekë dhe të depozitave në valutë;
- normat e interesit të depozitave në lekë pritet të ruajnë nivelet e ulëta që kanë arritur ndërsa për normat e interesit të depozitave në valutë pritet të ketë rritje. Normat e interesit të depozitave në lekë do të reagojnë në varësi të lëvizjes së normës së repos dhe politikave konkurruese të bankave;
- politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka ndikuar normat e interesit me anë të vendimeve për uljen e normës së repos. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë vlerësohet e efektshme në rritjen e efikasitetit të sistemit bankar.